

PYETJE TË SHPESHTA: Kodi i Sjelljes për Fushatat Digjitale në Shqipëri

Q: Çfarë është Kodi i Sjelljes për Fushatat Digjitale për zgjedhjet parlamentare të 11 majit në Shqipëri?

A: Kodi i Sjelljes për Fushatat Digjitale është një numër angazhimesh vullnetare që partitë politike dhe kandidatët bien dakord t'i respektojnë për të promovuar fushata të drejta, transparente dhe etike, sidomos *online*. Kodi është hartuar nga Instituti për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore, (International IDEA), Qendra për Sundimin e Ligjit në Universitetin e Helsinkit, Instituti Demokratik Amerikan (NDI), në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si dhe me kontribut nga partitë politike dhe shoqëria civile.

Kodi është bazuar në nisma të ngjashme të International IDEA në [Hollandë](#) dhe në [zgjedhjet parlamentare evropiane 2024](#).

Q: Kush e ka nënshkruar Kodin?

A: Një pjesë e madhe e partive politike, tradicionale dhe të reja, që garojnë në zgjedhjet e 11 majit, nënshkruan Kodin më 25 mars 2025.

Nëpërmjet nënshkrimit, aktorët politikë angazhohen të respektojnë vlerat thelbësore demokratike, si integritetin, transparencën, privatësinë, sigurinë, drejtësinë dhe barazinë në zgjedhje.

Kodi mbetet i hapur për nënshkrim nga aktorë të tjerë që nuk e kanë nënshkruar ende. Lutemi, kontaktoni emer.mbiemer@kqz.gov.al pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëse dëshironi t'i bashkoheni firmëtarëve të tjerë.

Q: Si lindi nevoja për këtë Kod?

A: Kodi u hartua për të adresuar shqetësimet në rritje mbi praktikën në fushatat digjitale, teksa kjo fushë mbetet gjerësisht e parregulluar. Dezinformimi dhe përmbajtja e manipuluar janë identifikuar si kërcënime për zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Financimet jotransparente të fushatave zgjedhore përbëjnë gjithashtu shqetësim. Po ashtu, numri në rritje i reklamave politike në media sociale, keqpërdorimi i të dhënave personale dhe teknologjitë e reja, si inteligjenca artificiale, përbëjnë sfida të reja për integritetin zgjedhor. Në përgjigje të këtyre sfidave, Kodi vendos standardet bazë të etikës për fushatat *online*.

Pra, Kodi ka për qëllim të forcojë besimin e publikut në zgjedhje duke u siguruar që të gjithë firmëtarët sillen në mënyrë të ndershme dhe transparente teksa zhvillojnë fushatën e tyre në internet. Së fundmi, Kodi ndihmon Shqipërinë të ndjekë praktika të njëjta si në Bashkimin Evropian, ku vendi aspiron të anëtarësohet.

Q: Ku mund ta lexoj Kodin e Sjelljes? Si informohet publiku mbi këtë Kod dhe firmëtarët e tij?

A: Teksti i plotë i Kodit gjendet [në faqen zyrtare të KQZ-së](#). Ju mund ta shkarkoni ose shikoni dokumentin për të lexuar secilin angazhim.

Leximi i Kodit është mënyra më e mirë për të kuptuar të gjitha nuancat e tij dhe angazhimet për të cilat palët nënshkruese kanë rënë dakord.

Q: Kush është subjekt i Kodit?

A: Firmëtarët kryesorë janë subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhjet parlamentare të 11 majit

në Shqipëri. Deri më 26 mars, 10 parti politike kanë nënshkruar Kodin. Kodi është i hapur për nënshkrim për të gjitha partitë politike dhe kandidatët garues në zgjedhjet parlamentare të 11 majit si dhe në zgjedhje të tjera në të ardhmen. Kodi nuk kufizohet vetëm në sjelljen e subjekteve zgjedhore në internet, por mbulon aspekte të fushatës si online, ashtu dhe në terren, si dhe të përmbajtjes politike të paguar ose jo.

Natyra gjithëpërfshirëse e Kodit siguron që standardet etike respektohen për të gjitha format e fushatës, digjitale ose jo.

Q: A përmban Kodi detyrime ligjore?

A: Jo. Kodi i Sjelljes zbatohet në baza **vullnetare**. Ai nuk zëvendëson apo anashkalon ligjet në fuqi.

Firmëtarët angazhohen ta zbatojnë atë në mirëbesim, por ata nuk do t'i nënshtrohen sanksioneve formale. Kodi është një mjet vetërregullues, i cili mbulon ato aspekte të fushatës në hapësirën digjitale që mbeten gjerësisht të parregulluara. Më e rëndësishmja, Kodi është në përputhje me ligjet dhe normat në fuqi mbi zgjedhjet, median, mbrojtjen e të dhënave personale, etj., dhe ka për qëllim t'i plotësojë ato. Kodi duhet lexuar në harmoni me ligjet e vendit dhe normat e BE-së që Shqipëria zbaton.

Q: Cilat janë angazhimet kryesore të Kodit?

A: Angazhimet mbulojnë disa tema, nga të bërit fushatë në mënyrë të ndershme tek praktikatat e lidhura me përdorimin e teknologjisë. Në mënyrë të përmbledhur, firmëtarët angazhohen:

- të promovojnë integritetin zgjedhor duke ndjekur të gjithat rregullat dhe parimet e të bërit fushatë në mënyrë të drejtë;
- të promovojnë debatin politik gjithëpërfshirës dhe etik (pa gjuhë urrejtje apo thirrje për dhunë);
- të mos shpërndajnë deklarata diskriminuese bazuar tek gjinia, etnia, feja dhe besimi, paaftësia, mosha, apo orientimi seksual;
- të mos dezinformojnë apo krijojnë përmbajtje të manipuluar (përfshirë *deepfakes* dhe llogaritë false);
- të përdorin në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme teknologjitë e reja, si inteligjencën artificiale;
- të jenë transparentë për financat e fushatës dhe reklamatat politike;
- të respektojnë privatësinë e të dhënave dhe të shmangin mikrotargetimin jo-etik;
- të përmirësojnë praktikatat e sigurisë kibernetike;
- të bashkëpunojnë dhe zbatojnë masat e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies (heqja e përmbajtjeve në shkelje të Kodit, të lejojnë vëzhgimin/monitorimin, etj.).

Secila prej këtyre fushave detajohet në listën prej 14 angazhimesh të Kodit. Tekstin e plotë të Kodit e gjeni [këtu](#).

Q: Si do të monitorohet respektimi i Kodit nëse është vullnetar?

A: Ndonëse Kodi nuk ka fuqi ligjore, procesi përfshin disa nivele mbikëqyrjeje. Së pari, firmëtarët angazhohen të shpërndajnë dhe promovojnë Kodin së brendshmi në partitë e tyre politike për të siguruar respektimin nga kandidatët individualë. Mbikëqyrja e përbashkët mes palëve nënshkruese do të funksionojë si një garanci shtesë për promovimin e llogaridhënies së

ndërsjellë dhe forcimit të angazhimit kolektiv ndaj dispozitave të Kodit. Së dyti, mbikëqyrja publike e cila ushtrohet nëpërmjet mbulimit mediatik dhe angazhimit qytetar, do të shërbejë si një mekanizëm i jashtëm llogaridhënie. Së treti, duke qenë se Kodi është publik, organizata të pavarura që vëzhgojnë zgjedhjet do të jenë në gjendje të monitorojnë pajtueshmërinë dhe të ngrejnjë shqetësime sipas rastit.

Së fundmi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), brenda kompetencave që i garanton ligji, monitoron veprimtaritë zgjedhore, duke reaguar ndaj çdo shkeljeje të rregullave zgjedhore.

Q: Çfarë ndodh nëse një palë shkel Kodin?

A: Nëse një nga palët nënshkruese shkel një nga angazhimet, Kodi bën thirrje për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese.

Për shembull, nëse një parti politike, kandidat apo staf i fushatës poston një video të manipuluar që shkel Kodin, është përgjegjësia e partisë për ta hequr atë menjëherë sapo e identifikon.

Kodi nuk përmban sanksione ligjore, por pasojat e vërteta janë reputacionale. Firmëtarët e tjerë, votuesit dhe publiku do të jenë në dijeni të shkeljes, gjë që mund të dëmtojë besueshmërinë e partisë. Kodi krijon një detyrim moral dhe politik, mospërmbushja e të cilit nënkupton mosmbajtjen e një premtimi ndaj votuesve dhe partive të tjera, gjë që mund t'i kushtojë shkelësit besimin e publikut.

Q: Si pritët që partitë ta zbatojnë Kodin së brendshmi?

A: Partitë nuk po nënshkruajnë vetëm një dokument. Ato duhet t'i përshijnë këto angazhime në kulturën e tyre të bërit fushatë. Kodi i bën thirrje firmëtarëve që të ndërgjegjësojnë stafin e fushatës, vullnetarët dhe organizatat e ndërlidhura mbi përmbajtjen e tij.

Partitë inkurajohen të organizojnë trajnime për këdo që përfshihet në fushatë për çfarë lejohet nga Kodi dhe çfarë jo. Për shembull, një parti mund të caktojë një person përgjegjës për të ndihmuar me zbatimin e Kodit. Ajo mund të organizojë sesione trajnimi dhe informimi për stafin e medias sociale mbi çfarë mund të bëhet dhe çfarë jo (jo llogari false, jo mesazhe urrejtje, etj.). Gjithashtu, kryesia e partisë (kryetarët, sekretarët e përgjithshëm dhe drejtuesit lokalë) duhet të diskutojnë se si ta zbatojnë Kodin në veprimtaritë e rregullta të fushatës.

Shkurtimisht, zbatimi është një proces i vazhdueshëm, i cili përfshin edukimin, udhëzimet e brendshme dhe mbështetjen nga kryesia, në mënyrë që vlerat e Kodit të reflektohen në veprimet e përditshme të fushatës.

Q: Çfarë ndodh me Kodin pas zgjedhjeve?

A: Kodi nuk është një premtim i vetëm që më pas harrohet. Hartuesit e Kodit dhe KQZ-ja i kanë propozuar firmëtarëve zhvillimin e një vlerësimi paszgjedhor për të parë se si Kodi është zbatuar dhe për të rekomanduar përmirësime të mëtejshme në zgjedhjet e ardhshme.

Partitë politike ranë dakord që të mblidhen pas zgjedhjeve të përgjithshme 2025 për të vlerësuar se çfarë funksionoi dhe çfarë jo, si dhe mënyrat e përmirësimit të Kodit për zgjedhjet e ardhshme. Procesi i vlerësimit paszgjedhor është i rëndësishëm sepse mundëson zhvillimin e Kodit nëse dalin sfida të reja në fushatat digjitale ose nëse disa nga angazhimet janë të vështira për t'u zbatuar, në bazë të cilave diskutohen edhe përshtatjet. Gjithashtu, ky proces vlerësimi mundëson vijimësinë e bashkëpunimit midis cikleve zgjedhore. Kështu që mund të presim që ky Kod Sjelljeje të rishikohet dhe mundësisht të forcohet, bazuar në përvojën e zgjedhjeve të 2025.

Nëse keni pyetje të tjera lidhur me Kodin, ju lutem dërgojani ato stafit të IDEA International në m.gjoncaj@idea.int dhe NDI në vplepi@ndi.org. Ne do të shtojmë përgjigjen ndaj pyetjes tuaj në këtë dokument.